

5. INFRASTRUKTURA TEKNOLOGJIKE

Një sistem pagesash i sigurt dhe eficient është një faktor i rëndësishëm në shlyerjen e transaksioneve në tregjet financiare si dhe në stabilitetin e sistemit financiar. Roli i Bankës së Shqipërisë në mbikëqyrjen e sistemeve të pagesave synon nxitjen dhe mbështetjen e mirëfunksionimit të sistemeve dhe instrumenteve të pagesave, veçanërisht me qëllim që të arrihet:

- a) stabiliteti dhe besueshmëria e sistemeve të pagesave, duke identifikuar, parandaluar dhe zgjidhur në kohë rreziqet e mundshme;
- b) transparenca e kuadrit operacional të sistemeve të pagesave dhe eficientia e tyre;
- c) ruajtja e besimit të publikut në instrumentet dhe shërbimet e pagesave që përdoren;
- d) promovimi i automatizimit në përdorimin dhe procesimin e instrumenteve të pagesave si dhe ndëroperabiliteti i sistemeve mbështetëse.

Banka e Shqipërisë zotëron dhe administron dy sisteme të pagesave në lekë: "Sistemi i shlyerjes së pagesave ndërbankare me vlerë të madhe - AIPS"¹⁰ dhe "Sistemi i klerimit të pagesave me vlerë të vogël – AECH"¹¹. Të dyja sistemet, kanë filluar të operojnë prej katër vjetësh dhe janë përmirësuar në vazhdimësi, duke synuar ruajtjen e eficientës së tyre. Karakteristikat teknike të funksionimit tregojnë shkallën e sigurisë dhe të eficientës. Kështu, sistemi AIPS ka qenë i aksesueshëm nga pjesëmarrësit në 99.85 për qind të orarit të tij të operimit, pra, në 248 ditë pune sistemi ka qenë i padisponueshëm vetëm për 2 orë e 35 minuta, si pasojë e problemeve teknologjike apo teknike.

Gjatë vitit 2007, numri i transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS është rritur me 17 për qind, krahasuar me vitin 2006. Ndërkohë pagesat e procesuara në sistemin AECH, pothuajse janë dyfishuar, duke u rritur me 47 për qind krahasuar me vitin 2006. Numri më i madh i transaksioneve është përqendruar në tremujorin e fundit të vitit, veçanërisht për sistemin AECH.

Mesatarisht, çdo ditë në sistemin AIPS janë procesuar rreth 183 transaksione me një vlerë totale prej 15.1 miliardë lekësh, ndërsa në sistemin AECH rreth 290 transaksione me një vlerë totale ditore prej 48 milionë lekësh. Tabelat në vijim pasqyrojnë numrin dhe vlerën totale të pagesave të procesuara, përkatësisht në sistemet AIPS dhe AECH, gjatë vitit 2007, krahasuar me vitin 2006:

Tabelë 7. Tregues për transaksionet në sistemin AIPS.

Sistemi AIPS	2006	2007
Numri i transaksioneve	38,793	45,480
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3,376	3,745
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	87.01	82.34

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 8. Tregues për transaksionet në sistemin AECH.

Sistemi AECH	2006	2007
Numri i transaksioneve	48,889	71,857
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	7.77	11.99
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	0.16	0.17

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Përveç numrit të transaksioneve të procesuara në sisteme, rritje të rëndësishme ka patur edhe vlera e tyre. Gjatë vitit 2007, rritja në vlerën e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS dhe atë AECH rezulton të jetë përkatësisht me 11 dhe 56 për qind, krahasuar me vitin 2006. Vlera totale e likuiditeteve të shlyera në sistemet e pagesave gjatë vitit 2007, rezulton të jetë katërfishi i vlerës së Prodhimit të Brendshëm Bruto për vitin¹².

Në mënyrë më të detajuar, llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS gjatë vitit 2007 dhe pesha e tyre relative, paraqiten në tabelën 9:

Tabelë 9. Llojet e transaksioneve të procesuara në sistemin AIPS.

Lloji i pagesës	Volum		Vlerë (në miliardë lekë)	
	Vlerë absolute	Peshë relative	Vlerë absolute	Peshë relative
Transaksione të B.SH	7,467	16.4%	2,166.55	57.9%
Transferim fondesh cash	8,455	18.6%	221.43	5.9%
Pagesa ndërbankare	7,831	17.2%	664.49	17.7%
Pagesa për klientët	16,506	36.3%	134.93	3.6%
Shlyerje në bazë neto	3,224	7.1%	8.99	0.2%
Shlyerje letra me vlerë të qeverisë	1,997	4.4%	548.46	14.6%
Totali	45,480	100%	3,744.85	100%

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Krahasuar me të njëjtët zëra të vitit të kaluar, vërejmë se një peshë të konsiderueshme në rritjen e numrit të transaksioneve, zë numri i pagesave për klientët. Përsa i përket vlerës së transaksioneve, rritje e konsiderueshme reflektohet në zërin e transaksioneve të iniciuara nga Banka e Shqipërisë, si edhe në transaksionet ndërbankare.

Nga pikëpamja e mbikëqyrjes dhe vlerësimit të stabilitetit të sistemeve të pagesave, vlerësohet edhe shkalla e përqendrimit të pagesave në një të veçanta të rrjetit. Tregues të përqendrimit për dy sistemet AIPS dhe AECH, paraqiten si në tabelën 10 dhe 11:

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (mld lekë)
Sistemi AIPS	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka ¹³	33%	30%
5 banka	45%	39%
Totali (vlerë absolute)	45,480	3,745

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 10. Tregues të përqendrimit për sistemin AIPS.

	Vëllim transaksionesh	Vlerë transaksionesh (mln lekë)
Sistemi AECH	Peshë/Totalit	Peshë/Totalit
3 banka ¹⁴	50%	53%
5 banka	66%	65%
Totali (vlerë absolute)	71,587	11,997

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 11. Tregues të përqendrimit për sistemin AECH.

Bankat kanë përdorur lehtësinë që ofron sistemi i pagesave për “kreditë brenda ditës”. Krahasuar me vitin 2006, numri dhe vlera e transaksioneve për “kreditë brenda ditës” gjatë vitit 2007, janë rritur përkatësisht me 52 dhe 47 për qind.

Tabelë 12. Përdorimi i kredisë brenda ditës.

Kredi brenda ditës (ILF)	2006	2007
Numri i transaksioneve	444	675
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	146.32	217.51
Vlera mesatare e transaksionit (milionë lekë)	329.55	322.24

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2007, 11 banka kanë përdorur “kreditin brenda ditës”, 3 më shumë se gjatë vitit 2006. Nga analiza e përqendrimit të transaksioneve sipas bankave, konstatohet se 5 banka kanë qenë aktive në përdorimin e këtij instrumenti, për menaxhimin e likuiditetit brenda ditës. Rreth 85 për qind e totalit të vlerës së “kredisë brenda ditës”, është e përqendruar në dy banka.

Në tërësinë e sistemit të pagesave, Banka e Shqipërisë ofron edhe shërbimin e klerimit dhe shlyerjes në bazë neto, të vlerës së çeqeve të procesuara nga bankat. Përdorimi i çekut si instrument pagese në formë “letër”, në Shqipëri ka vazhduar të jetë në rënie edhe gjatë vitit 2007, si në numër (45 për qind më pak çeqe të shlyera), ashtu edhe në vlerë (65 për qind më pak vlerë monetare e shlyer), krahasuar me vitin 2006. Peshën kryesore në rënie e zë përdorimi gjithnjë e më i ulët i çekut bankar.

Tabelë 13. Shlyerja e çeqeve në AIPS.

Shlyerja e çeqeve në AIPS	2006	2007
Numri i çeqeve të shlyera	994	544
Vlera e çeqeve (miliardë lekë)	3.76	1.33

Burimi: Banka e Shqipërisë.

5.1. INSTRUMENTET E PAGESAVE ELEKTRONIKE

Instrumentet e pagesave elektronike dhe numri i transaksioneve që kryhen me to, po rriten gjithnjë e më shumë. Gjatë vitit 2007, vërehet një rritje e konsiderueshme, prej 74 për qind e numrit të kartave në përdorim, kryesisht karta me funksion debiti/cash-i, krahasuar me vitin 2006. Janë shtuar gjithashtu terminalat për përdorimin e kartave, kryesisht terminalat POS të vendosura në pika shitjeje, me një rritje prej 47 për qind krahasuar me numrin e tyre në fund të vitit 2006. Përsa i përket shpërndarjes gjeografike të terminaleve ATM dhe POS të ofruara nga bankat, mund të themi se përqendrimi më i madh i tyre është në rajonin e Tiranës. Gjithsesi, vlen të përmendet një tendencë në rritje e shtrirjes së tyre edhe në qytetet e tjera të Shqipërisë.

Tabelë 14. Përdorimi i kartave bankare.

Karta bankare	2006	2007
Numri i kartave të debetit/cash-i	335,856	591,355
Numri i kartave të kreditit	9,754	12,991

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 15. Numri i terminaleve ATM dhe POS.

Terminale ATM dhe POS	2006	2007
Numri i terminaleve ATM	309	443
Numri i terminaleve POS	1,234	1,832

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Pavarësisht rritjes së konsiderueshme të numrit të kartave apo terminaleve për përdorimin e tyre, një rritje më modeste vërehet në numrin dhe në vlerën e transaksioneve që kryhen me karta bankare, respektivisht prej 17 dhe 26 për qind. Kjo shpjegohet nga fakti se kartëmbajtësit ende nuk kanë besimin e duhur dhe/apo mundësitë për ta përdorur kartën si mjet pagese. Thënë ndryshe, në përpjestim me numrin e popullsisë¹⁵, mesatarisht, një në pesë persona është mbajtës i një karte dhe çdo kartëmbajtës kryen jo më shumë se 16 transaksione në vit. Pra, sistemi bankar është akoma në hapat e parë të përdorimit të instrumenteve të pagesave elektronike, krahasuar me statistikat e raportuara nga vendet e rajonit.

Karta Debiti	2006	2007
Numri i transaksioneve (mijë)	8,053	9,249
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	47.81	59.04
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	5,940	6,390

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 16. Transaksionet me kartat e debitit.

Karta Krediti	2006	2007
Numri i transaksioneve (mijë)	176	363
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	3.2	5.3
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	18,207	14,635

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 17. Transaksionet me kartat e kreditit.

Prirje pozitive vërehet edhe në lidhje me përdorimin e “Home Banking”, si instrument elektronik pagese. Aktualisht, në Shqipëri janë tre banka që ofrojnë shërbime me këtë instrument pagese. Krahasuar me vitin 2006, gjatë vitit 2007 vërehet një rritje përkatësisht prej 122 për qind në numrin e transaksioneve “Home Banking” dhe 188 për qind rritje, në vlerën e transaksioneve të procesuara. Kjo rritje kryesisht është pasojë e shtimit të 2 bankave në ofrimin e këtij shërbimi, gjatë vitit 2007.

Home Banking	2006	2007
Numri i transaksioneve	19,096	42,447
Vlera e transaksioneve (miliardë lekë)	16.83	48.49
Vlera mesatare e transaksionit (lekë)	881.34	1,142.36

Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 18. Përdorimi i home – banking.

5.2. MBIKËQYRJA E SISTEMEVE TË PAGESAVE

“Mbikëqyrja e sistemeve të pagesave dhe të shlyerjes është një funksion i Bankës Qendrore, sipas të cilit, objektivat e sigurisë dhe eficiencës promovohen duke monitoruar sistemet ekzistuese dhe të planifikuara, duke i vlerësuar ato kundrejt këtyre objektivave dhe, aty ku është e nevojshme, duke stimuluar ndryshime”¹⁶.

Gjatë vitit 2007, puna e Bankës së Shqipërisë në lidhje me këtë funksion, u përqendrua në: